



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 112, Datë 21.04.2026

MBI

**MODIFIKIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “EZ-5 ENERGY” SH.P.K. NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI
FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 30 MW**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 13 dhe 15 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.04.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 485/6 prot., datë 17.04.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 30 MW”,

Konstatohet se:

1. Të dhëna për shoqërinë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k.

- Shoqëria “EZ-5 ENERGY” sh.p.k., është licencuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 171, datë 31.07.2025, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 30 MW.
- Nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 244, datë 30.04.2025 dhe Kontratës nr. 4456 rep., nr. 2040 kol., datë 27.05.2025, të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), shoqëria është pajisur me të drejtën për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 30 MW, dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt konçesioni, në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqëria “EZ-5 ENERGY” sh.p.k.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 75, datë 12.03.2026, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë për prodhimin e energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 13.03.2026 dhe 14.03.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga palët e treta (data 14.04.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen e internetit të ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 485/3 prot., datë 18.03.2026, ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe “Operatorin e Sistemit të Transmetimit” OST sh.a., për fillimin e kësaj procedure. Nga ana e tyre nuk rezulton të ketë pasur kthim përgjigjeje.
- Me shkresën nr. 485/4 prot., datë 18.03.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së saj, si dhe i ka bërë me dije në lidhje me informacionin/dokumentacionin që duhet të plotësohet për këtë aplikim.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 485/5 prot., datë 24.03.2026, shoqëria ka depozituar informacionin/dokumentacionin e munguar.

2. Përputhshmëria e Aplikimit me Rregulloren

- Në përputhje me nenin 15, pika 4 e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, shoqëria ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për modifikimin e licencës sipas gërmave a, b, c, d, e, f dhe g, si dhe ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të Rregullores.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të modifikojë licencën e shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 171, datë 31.07.2025, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 30 MW, duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike në Aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI